



RAPORTI I DHUNIMIT TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE LGBT

Tiranë, Janar – Dhjetor 2013

© Ambasada PINK /LGBT Pro Shqipëri

Dhunimi i të Drejtave të personave LGBT, 2013

Raste të raportuara pranë Ambasadës PINK / LGBT Pro Shqipëri ose të monitoruara përmes Medias

Mars 2013

⇒ RASTI 'SPAHIA'

Në puntatën e 19-të, të emisionit "Debati në Channel One" të datës 21.03.2013, transmetuar në televizionin "Channel One", me temë "Pedofilia në Shqipëri", u diskutua lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve, duke marrë shkas nga ngjarja e ndodhur në Qytetin e Tiranës, ku një fëmijë është zhdukur dhe një tjetër është dhunuar seksualisht. Në këtë emision ishin të ftuar gazetarë, analistë dhe politikanë. Ndër të ftuarit në këtë emision ishte dhe z. Ekrem Spahia, politikan, aktualisht Kryetar i Partisë Lëvizja e Legalitetit dhe Zv/Ministër i Mbrojtjes.

Në një analizë që z. Spahia i bën shkaqeve që kanë çuar në një situatë të tillë, shprehet ndër të tjera për "ato e ngrejne zërin duke ndihmuar edhe media, për një kategori që kërkojnë të na e imponojnë si një vlerë për shoqërinë shqiptare, siç janë homosensualët dhe merren më shumë me ata, dhe nuk merren pikërisht me fëmijët që ata janë krejtësisht pasojat e kësaj lirie që kërkojmë" ose "OJQ-të, po pikërisht ato stimulojnë atë kategori njerëzish që çojnë në këto krime monstruoze dhe prandaj ne jemi kategorikisht kundër tyre,ato kanë një tendencë që të bëjnë sa më shumë, më falni se ne na vjen zor qoftë me e përmend..., jo më ta aplikojmë, të bëjmë sa më shumë homoseksualë. Dhe

atëherë kjo është tendenca e tyre ti mashtrojnë fëmijët me pare, se kanë para ato.....Pra gjëja më pavlerë në shoqërinë njerëzore, kërkojnë të na e imponojnë, na kundërvihen se është një civilizim dhe është njeri modern ai që qënka homoseksual. Dhe kujt tu drejtohen këta fëmijë, te ata njerëz që duan të shtojnë radhët e tyre dhe të na i nxjerrin nëpër bulevardet e Tiranës"

Pas këtij transmetimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: "Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji", nenin 46 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: "Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara, Komisioneri me urdherin nr. 37 , datë 05.04.2013, filloi procedimin administrativ kundër z. Ekrem Spahia, i ftuar në këtë emision.

Pas procedimit KMD vendosi se Deklaratat e z. Ekrem Spahia janë diskriminim i drejtpërdrejtë pasi ato paragjykojnë dinjitetin dhe çenojnë të drejtën për siguri dhe mbrojtjen nga dhuna të personave për shkak të

orientimit seksual; Detyrimin e z. Ekrem Spahia, të kërkojë publikisht ndjesë brenda 15 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e gjuhës e cila prodhon efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër personave për shkak të orientimit seksual; Detyrohet z. Ekrem Spahia, që brenda 30 ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi dhe moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.¹

⇒ RASTI 'LAME'

Më datë 23 Mars 2013, në Gazetën Shqip publikohet një shkrim i Z. Artan Lame me titull "Dështimet e Shtetit".² Ky shkrim ka një përmbajtje të hapur diskriminuese, homofobike dhe keq-informuese ndaj komunitetit dhe lëvizjes LGBT.

Në këtë shkrim z.Lame i konsideron personat LGBT si devijantë të lindur, perversë dhe i personifikon ata me pedofilët. Më specifikisht në një nga paragrafët e shkrimit citohet "U legalizuan dhe na mbytën gjithfarëlloj perversitetesh, deviacionesh dhe termash. Homoseksualë, tranvestitë, homofobia, lesbike, transeksualë, pedofobia, pink, gender e ç'tu them tjetër."

Menjëherë pas shkrimit PE reagon përmes një Letre të Hapur drejtuar

¹ Referuar dokumentacionit dhe vendimit tw KMD

² <http://gazeta.shqip.com/lajme/2013/03/23deshtimet-e-shtetit/>

kryetarit të PS, për të shprehur indinjatën lidhur me shkrimin dhe për të kërkuar të distancohej publikisht prej qëndrimeve të z. Lame, duke ditur se ai është një nga anëtarët e strukturave drejtuese të PS dhe se qëndrime të tilla të shprehura nga një figurë publike së pari keqinformojnë publikun e gjerë, së dyti nxisin urrejtjen ndaj qytetarëve, dhe së treti lehtësisht mund të perceptohen si qëndrim zyrtar i forcës politike ku ai aderon, në këtë rast Partia Socialiste e Shqipërisë. Letra pati publikim të gjerë në media.³ Por asnjë reagim qoftë ky publik apo i personalizuar nuk erdhi nga z. Rama.

Gjithashtu PE dërgon një letër edhe tek z. Lame duke i kërkuar të distancohej publikisht prej këtyre qëndrimeve homofobike dhe diskriminuese përkundrejt të drejtave të personave LGBT në Shqipëri shoqëruar me material informues rreth orientimit seksual dhe identitetit gjinor, por edhe pas kësaj asgjë nuk ndryshoi në reagimin e z. Lame. Ai vazhdoi me po të njëjtat qëndrime edhe në emisionin "Triçikël" të datës 30 Mars, në Top Albania Radio.⁴

³

<http://www.respublica.al/artikuj/2013/03/29/na-mbyten-gjithfare-lloj-perversitetesh-shkruan-lame-ambasada-pink-i-kerkon-rames>
<http://www.gazetatema.net/web/2013/03/29/ambasada-pink-i-shkruan-rames-kunder-artan-lames-ps-te-distancohet-nga-qendrimet-homofobike-te-tij/>
<http://www.yandalo.comwww.kohajone.com/artikull.php?idm=67727>
http://www.balkanweb.com/bw_lajme2.php?ID_Categoria=2707&IDNotizia=126258&res_start=10
<http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/03/29/ambasada-pink-rames-distancohu-nga-artan-lame/>

⁴

http://www.youtube.com/watch?v=7_aFFaRhf8

PE, në të njëjtën kohë dërgon tek KMD një ankesë ndaj z. Lame për diskriminim ndaj komunitetit LGBT dhe Ambasadës PINK. KMD pasi e shqyrton ankesën del me konstatimin se shprehjet e Z. Lame janë diskriminuese pasi ato paragjykojnë dinjitetin dhe çenonjë sigurinë për mbrojtjen nga dhuna të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Z. Lame është ngarkuar me detyrimin për të kërkuar publikisht ndjesë brenda 15 ditëve nga marrja në dijeni për këtë vendim dhe të evitohet në të ardhmen përdorimin e gjuhës e cila prodhon efektin e përhapjes, nxitjen e urrejtjes apo të tjera forma të diskriminimit kundër personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre.

Prill 2013

⇒ RASTI 'D.E.'

Më datë 22 Prill, një rast është paraqitur pranë zyrave të PE për të raportuar dhunën e ushtruar mbi të nga familjarët dhe dëbimin nga familja. Djali nga Elbasani, 36 vjeç, vjen pranë zyrave të PE, pasi kish kontaktuar më parë me stafin përmes e-mail të organizatës. D.E. rrëfeu gjithë ngjarjen dhe situatën në të cilën ndodhej. D.E. ishte shumë i frikësuar, në gjendje të rëndë psikologjike për shkak të dhunës dhe kërcënimeve të vazhdueshme me vdekje nga familjarët e tij pasi kishin mësuar për orientimin e tij seksual (të vërtetuara këto edhe përmes rrjetit social Facebook).

D.E. u informua nga PE për të gjitha opsionet ndihmëse si: denoncimi në polici për kërcënimet që merr nga vëllezërit apo për ankesë tek KMD. Por nuk pranon të çoj çështjen tek

institucionet pasi nuk do të acaroj më tej marrëdhënien me familjarët.

PE i ofroi gjithë mbështetjen e saj si për informacion ashtu edhe për suport psikologjik apo duke e orientuar për gjetjen e një pune në profesionin e tij. P.E vazhdon të mbajë kontakte me D.E. përmes mail, telefonit dhe takimeve të drejtpërdrejta.

Tetor 2013

⇒ RASTI I DY VAJZAVE LEZBIKE

Me 18 tetor 2013, në një Fast Food tek "21 Dhjetori" në Tiranë, dy vajzave lezbike nuk i është ofruar shërbimi i Fast Food-it nga kamarieri i cili ka ofenduar vajzat dhe më pas ka tentuar ti sulmojë ato me objekte të forta. Në këtë pikë kamarieri është ndaluar nga punonjës të tjerë të këtij Fast Food-i dhe vajzat janë larguar. Pasi komunikuan me Aleancën LGBT vajzat e raportuan rastin tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe deri tani nuk kanë patur përgjigje, dimë vetëm që hetimet nga zyra e KMD kanë nisur⁵.

Dhjetor 2013

⇒ RASTI 'GAZETARI'

Një nga gazetarët me të njohur në qytetin e Durrësit, Z. Artur Ajazi, publikoi në gaztën Telegraf të 19 Dhjetorit 2013 një shkrim homofobik me titullin: "Durrës, zbluohet dhe goditet baza e homoseksualëve në

⁵<http://lgbt.historia-ime.com/index.php/ditari/414-incidenti-me-kamarierin-ne-fast-food>

qytet". Në të njëjtin artikull identifikohet keqinformim për komunitetin LGBT, në lidhje me terminologjinë dhe gjuhën e përdorur e cila është shumë diskriminuese pasi personifikon personat LGBT si prostitute.

Ambasada PINK reagoi menjëherë për këtë lajm duke dorëzuar një ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një shkrim i cili diskriminon personat e komunitetit LGBT.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e ka marrë ankesën në shqyrtim dhe ka nisur hetimin.⁶

⁶ <http://gazetatelegraf.com/durres-zbulohen-edhe-goditen-bazat-e-homoseksualeve-ne-qytet/>